



VENDIM

Nr. 164, Datë 28.12.2015

**PËR
NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 142, DATË 26.11.2015 TË BORDIT
TË ERE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d”; 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Neni 128 të Kodit të Procedurave administrative, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndryshimin e vendimit Nr. 143, Datë 26.11.2015 të Bordit të ERE ;

Konstatoi se :

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k, është licencuar në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, me vendimin Nr. 143, Datë 26.11.2015 të Bordit të ERE
- Me vendimin Nr. 143, Datë 26.11.2015 është vendosur kushti që subjekti i licencuar të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim – taksave.
- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k ka depozituar në ERE vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim – taksave.
- Në pikën 2 të vendimin Nr. 143, Datë 26.11.2015 është parashikuar se me plotësimin e kushtit, ky vendim është subjekt rishikimi nga ERE.
- Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative i jep të drejtën organit të administratës, të ndryshojë/zëvendësojë aktet administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

Të ndryshojë Pikat 1 dhe 2 të vendimit Nr. 143, Datë 26.11.2015 të Bordit të ERE si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 30 – vjeçar.
2. Licensa e tregëtimit të energjisë elektrike e shoqërisë C&S Energy sh.p.k, i shtrin efektet e saj duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 143, datë 26.11.2015.
3. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI